



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 189/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës ekonomike “*Ervin Luzi*”, SHPK dhe “*Sinani Trading*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt “*Blerje materiale pastrimi dhe detergjente*”, me nr. REF-88696-03-01-2021, me fond limit 4,814,770.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.03.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “Murati D” SHPK
Adresa: Rr. Kavajës ish Kombinati Ushqimor godina 1-
katëshe Tiranë

Autoriteti kontraktor: Bashkia Fier
Adresa: Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4 të Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin
e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit
Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -
19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.03.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt “*Blerje materiale pastrimi dhe detergjente*”, me nr. REF-88696-03-01-2021, me fond limit 4,814,770.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.03.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

II.2. Në datën 12.03.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 18.03.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

Ervin Luzi p.f	3380000 lekë	kualifikuar
Sinani Trading SHPK	3752200 lekë	kualifikuar
Murati D SHPK	3887600 lekë	kualifikuar
Euro Mega 2010	3900050 lekë	kualifikuar
Anbim SHPK	3994247 lekë	kualifikuar
Kombi Invest SHPK	4090835 lekë	kualifikuar
Atlantik 3 SHPK	4250000 lekë	kualifikuar
3-SH SHPK	4334590 lekë	kualifikuar

II. 4 Në datën operatori ekonomik “Murati D” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor për skualifikimin e operatoreve ekonomik “Ervin Luzi”, SHPK dhe “Sinani Trading” SHPK në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

Nëpërmjet rrugëve elektronike me datë 18.03.2021 mësuam se KVO na ka radhitur të tretin nënvlerësimin e ofertave duke kualifikuar në vend të parë firmën "ERVIN LUZI" dhe firmën: "Sinan Trading" në vend të dytë. Pretendimi ynë është se KVO i ka kualifikuar padrejtësisht këto dy firma së pari shoqëritë në fjalë nuk plotësojnë kërkesat e kualifikimit si më poshtë. Të dyja shoqëritë nuk kanë plotësuar kriterin e vecante të kualifikimit, si më poshtë:

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti Vendor për vitin 2020, pranë njësisë vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës" si dhe ate :

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente për objektin që prokurohet (e cila duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe noterizuar) e lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër mendoj se KVO nuk duhet ti kishte kualifikuar këto dy shoqëri pasi nuk plotësojnë dy kërkesa kryesore të kërkesave për kualifikim. Dy kriteret e vecanta si kriteri 2.2.3 dhe ai 2.3.2 nuk janë plotësuar nga dy firmat e mësipërme. Pavarësisht këtyre fakteve KVO në kundërshtim të plotë me LPP i kualifikon në vend të parë dhe të dytë. Duke u nisur nga faktet e mësipërme kërkoj nga ana juaj që të verifikohen pretendimet tona dhe të skualifikohen nga konkurrimi.

1. Arsye tjeter është se dhe mostrat e paraqitura nga shoqëritë e mësipërme nuk plotësojnë kërkesat specifike të kërkuara për mallrat e ndryshem si:

1. Shtupa mikrofiber për parket të jone cilësore me shumë fije, të gjata e të mbushura me mikrofiber, të përshtatshme me bishtat (Vileda ose ekuivalente me të)". Ato u paraqitën pa bisht, ku thuhet me bisht. Shtupat e paraqitura ishin jo për parket, ato nuk ishin të gjata.

2. Peceta enësh / Peshqir te jënë cilësore, materiali pambuk, 50% e sasisë në madhësinë 50x50 cm dhe 50% e sasisë në madhësinë 30x40 cm. Mostrat e paraqitura nuk ishin 30x40cm por jashtë këtyre përmasave.

3. Pastrues për parket te jetë Pronto Legno pulito (5 in 1) parket në formatin 500 ml ose ekuivalente me të. Nuk ishte 500ml.

4. Pastrues për pllaka me aromë 1.5 lit, Ajax ose Mastro Lindo ose ekuivalente me të. Edhe kjo mostër ishte nën norme nga 1.5 lit u paraqit 1 litershe.

Të gjitha këto sa theksuam, keto dy oferta i bëjnë të pakualifikueshme. Por KVO është nisur thjeshtë nga vlera e tyre më e ulët, i ka kualifikuar duke hequr dorë nga kriteret kualifikues. Gjithashtu dua tju bëj me dije se që të dyja ofertat ishin anomalisht me të ulta duke pasur parasysh formulën përkatesë. Që ketu duket etja e KVO që pavarësisht të gjithave sa theksuam më sipër i kualifikon ato padrejtesisht. Ky fakt na habit ku kriteret e vendosura për kualifikim shndërrohen në të parëndësishme apo nuk perfillen fare. Atehere lind pyetja: Pse të kërkohen, pse vendosen këto kriteret? Këto të gjitha janë fakte që tregojnë se ketu ka një kualifikim jashtë kriterëve të kërkuara nga DST. Duke u nisur nga faktet e mësipërme kërkojmë nga ju si përfaqësues kryesor i bashkisë të verifikoni kërkesën time për të skualifikuar dy shoqëritë e mësipërme pasi nuk plotesojnë kushtet e kualifikimit sipas kërkesave të parashtruara në DST.

II.5. Në datën 30.03.2021 operatori ekonomik ankimues “Murati D” SHPK, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor. [...]Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm, të vëna në dispozicion nga Njësia e Prokurimit si: dokumentet e hedhura në sistem prej operatoreve ekonomike, perlllogaritjen e vlerës së fondit limit, DST për këtë procedurë, si dhe teresinë e dokumentacionit të nevojshëm të dosjes së tenderit, pasi u konsultua me legjislacionin në fuqi, me Udhezimet dhe Rekomandimet e APP-së, duke patur në konsideratë parimet e legjislacionit të prokurimit publik, si dhe duke qene të angazhuar për mbarevajtjen dhe ecurinë e këtij procesi dhe përfitimin në kohë të materialeve objekt prokurimi, në mënyrë sa më profesionale dhe sipas standardeve më të mira të tregut, parashtron si më poshtë vijon:

Ne këtë ankese subjekti ankimues “MURATI D” SHPK nuk ka paraqitur asnjë provë shkresore, argumente apo fakte për të vertetuar pretendimet e tij ndaj OE të tjere pjesmarres në këtë procedurë prokurimi publik. Bazuar në legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik, si edhe në praktiken e konsoliduar të KPP-së, subjekti ankimues duhet të paraqiste prova dhe fakte konkrete për të provuar pretendimet e tij. Për më tepër, pas verifikimeve që bëri Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës, të gjitha pretendimet e subjektit ankimues nuk qëndrojnë, pasi OE e tjere për të cilët subjekti ankimues ka pretendime të supozuara, kanë paraqitur dokumentacion të rregullt kualifikues, në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe kërkesat për kualifikim të percaktuara në DST.

Për këto arsye, pretendimet e subjektit ankimues nuk qëndrojnë.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe rrethanave të saj, autoriteti kontraktor Bashkia Fier, pasi analizoi pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesë, pasi u konsultua me dispozitat e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, V.K.M. nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, gjykon se pretendimet e subjektit ankimues

nuk qëndrojnë, pasi nuk gjejnë mbështetje në fakte, në prova dhe në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në V.K.M. nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, në DST, dhe në këto kushte ankesa datë 24.03.2021, protokolluar në Bashkinë Fier me nr.2593 prot. Datë 24.03.2021 e OE "MURATI D" SHPK, nuk pranohet.[...].

II.6. Në datën 24.03.2021 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

Te dy operatorët janë kualifikuar nga KVO vetëm se kanë pasur vlerën me të ulët pa u thelluar në dokumentacionin përkatës të kërkesave kualifikuese që janë kërkuar që operatorët të kualifikohen ashtu siç parashtron LPP : "se duhet të plotësohen të gjithë kërkesat kualifikuese të kërkuara nga AK' dhe vetëm atëherë mund të kualifikohet një shoqëri. Për pretendimet tona ndaj këtyre shoqërive se janë kualifikuar padrejtësisht duke neglizhuar apo anashkaluar kërkesat kualifikuese më datë 24.03.2021 ju drejtova autoriteteve të kësaj Bashkie, ku ju kërkoja të verifikonin dokumentacionin e këtyre shoqërive dhe të mbanin qëndrim deri në rivlerësim të ofertave .Në fakt nga përgjigjja e tyre në rrugë elektronike me datë 31.03.21 pavarësisht se shkresa e hedhur në email përmban datën 30.03.2021 në këtë përgjigje komisioni i verifikimit të ankesave thekson:" se shoqëritë në fjalë e kanë të gjithë dokumentacionin e duhur për tu kualifikuar". Në këtë mënyrë hedhin poshtë të gjitha pretendimet tona.

Shoqëria jonë ka krijuar bindje se dokumentacioni i shoqërive nuk plotëson kërkesat kualifikuese për tu kualifikuar ndaj duke pasur besim të plotë tek ju të KPP kërkojmë verifikimin e gjithë dokumentacionit të shoqërive ":ERVIN LUZI" SHPK dhe "Sinani Trading" SHPK.

2.3.2 Shoqëria : " ERVIN LUZI" SHPK nuk ka dokumentacionin e mëposhtem që kërkohen në piken;
2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikate të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente për objektin që prokurrohet (e cila duhet të jetë e perkthyer në shqip dhe e noterizuar) e lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

1-I mungon "CERTIFIKATA ISO 9001" kjo firmë është e certifikuar për materiale elektrike hidraulike dhe higjieno sanitare" por nuk është certifikuar për detergjente dhe materiale pastrimi. Pika :2.23 të kualifikimit thuhet:

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti Vendor për vitin 2020, pranë njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës"

2-Për ne nuk ka paguar të gjitha taksat bashkiake të vitit 2020 kundrejt shtrirjes së tij që ka aktivitet.

3-Nuk ka paraqitur ose nuk përputhet kontrata e ngjashme me objektin e tenderit . E thënë ndryshe nuk ka ose ka paraqitur kontratë të rreme për "detergjente dhe materiale pastrimi"

4-DST kërkojnë paraqitjen e mostrave sipas kërkeses kualifikuese:2.3.3 Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet) për disa prej artikujve si me poshte:

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentet e tenderit.

Nga demonstrimi i mostrave shikohet keto artikuj te paraqitur qe nuk plotesonin specifikimet teknike te kerkuara;

1- Shtupa mikrofiber për parket te jene cilesore me shume fije, të gjata e të mbushura me mikrofiber, të pershtatshme me bishtat (Vileda ose ekuivalente me te)". Ato u paraqiten pa bisht ku thuhet me bisht. Shtupat e paraqitura ishin jo per parket, ato nuk ishin të gjata.

2-Peceta enësh / Peshqir te jënë cilësore, materiali pambuk, 50% e sasise në madhësinë 50x50 cm dhe 50% e sasisë në madhësinë 30x40 cm. Mostrat e paraqitura nuk ishin 30x40cm por jashtë këtyre përmasave.

3-Pastrues për parket të jetë Pronto Legno pulito (5 in 1) parket në formatin 500 ml ose ekuivalente me të. Nuk ishte 500ml

Për shoqërinë: "Sinani Trading" mungon ose e ka te skaduar CERTIFIKATEN ISO 9001,

2-Nuk ka paguar taksat bashkiake për vitin 2020 sipas shtrirjes së aktivitetit qe ka nëper rrethet që ka nipt sekondar

3-Disa nga Mostrat e paraqitura janë jashtë specifikimeve teknike si:

1- Pastrues për pllaka me aromë 1.5 lit, Ajax ose Mastro Lindo ose ekuivalente me të.

Edhe kjo moster ishte nën normë nga 1.5 lit u paraqit 1 litershe.

2-Pastrues për parket të jetë Pronto Legno pulito (5 in 1) parket në formatin 500 ml ose ekuivalente me të.

Nuk ishte 500ml dhe marka nuk i përgjigjej kërkesave specifike.

3-Peceta enësh / Peshqir të jenë cilësor, materiali pambuk, 50% e sasise në madhësinë 50x50 cm dhe 50% e sasisë në madhësinë 30x40 cm. Mostrat e paraqitura nuk ishin 30x40cm por jashtë këtyre përmasave.

Të nderuar gjyqtar të KPP, sipas meje pretendimet e mësipërme janë konkrete dhe qëndrojnë për të dy operatorët nisur nga sa theksuam kërkojme verifikimin e plotë të dokumentave të paraqitura pranë KVO TE BASHKISE NE TENDER.

Duke u nisur nga këto fakte mendojmë se KVO ka shkelur LPP dhe ka kualifikuar shoqëritë të cilat kanë pasur defekte të mëdha në dokumentacion si dhe në paraqitjen e mostrave te cilat nuk plotesojnë specifikimet teknike të kërkuara per kualifikim.

Nisur dhe nga fakti i paraqitjes së mostrave jashtë specifikimeve teknike kanë dërguar që shoqëritë të ulin ofertat të cilat jane anomalish të uleta. Natyrisht me një mall të dobet jashtë specifikimeve dhe cmimet do jënë me të ulta.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 3232/1 prot 19.04.2021 protokolluar me tonën me nr.579/2 prot datë 19.04.2021 me objekt "Dërgohet informacioni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK me arsyen; [...] *Për shoqërinë : “Sinani Trading” mungon ose e ka të skaduar CERTIFIKATËN ISO 9001[...]*

III.1.1 Në dokumentet e tenderit Shtojca 8 pika 2.3 ”Për kapacitetin teknik”: parashikohet si më poshtë vijon :

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikate të menaxhimit të cilësive ISO 9001-2015 ose ekuivalente për objektin që prokurohet (e cila duhet të jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar) e leshuar nga Organizmat e Vleresimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohura ne Republikën e Shqiperise.*

III.1.2 Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.1.3 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Ervin Luzi” SHPK, ndër të tjera ka paraqitur:

- Certifikatë ISO 9001:2015, nr. AQS/Q/640112021 lëshuar nga organizmi i vlerësimit të konformitetit AQSCERT, për operatorin ekonomik “Sinani Trading”, SHPK në gjuhën shqipe dhe ne anglisht.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.1.5. Në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”*

III.1.6 Në nenin 30 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

1. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.7 . Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatës si ISO 9001:2015. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK, ka ngarkuar ne SPE Certifikatën lëshuar nga AQScert me kodin dhe me nr. Certificate nr.AQS/Q/640112021 ku është e përcaktuar dhe afati i vlefshmerise së kësaj certificate të cilën e ka deri më datë 24.01.2024.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ankimues “Murati D ” SHPK nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK me arsyen: *[...]2-Nuk ka paguar taksat bashkiake për vitin 2020 sipas shtrirjes së aktivitetit që ka nëpër rrethet që ka nipt sekondar [...]*

III.2,1 Në dokumentet e tenderit Shtojca 8 pika 2.2 “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”: parashikohet si më poshtë vijon :

Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, pranë njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

III.2.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterëve të mësipërme, operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Vërtetim datë 09.12.2020, lëshuar nga Bashkia Lushnje
2. Vërtetim datë 02.07.2020, lëshuar nga Bashkia Maliq

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.2.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*

III.2.5. Pika 2 e nenit 10 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parashikon: *““Vendndodhje e biznesit” është çdo dyqan, njësi e veçantë ose vende të tjera të palëvizshme, ku kryhet biznes. Kur nuk ekziston një vend fiks biznesi, vendndodhja e biznesit, që ushtrohet nga një person fizik, është banesa private e taksapaguesit.”*

III.2.6. Pika 2 e nenit 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parashikon: *“[...]Detyrimi i taksës për t’u paguar nga çdo biznes, në çdo vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit, që kryhet në kohën e regjistrimit dhe reregjistrimit të tij[...].”*

III.2.7. Nga verifikimet e kryera nga KPP, referuar Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar të subjektit «Sinani Trading» SHPK konstatohet se ky i fundit ka ushtruar aktivitet gjatë vitit 2020 në qytetin e Lushnjes dhe Maliq. Nga shqyrtimi i vërtetimeve të lëshuara nga Bashkitë përkatëse të cilat janë njësitë vendore të vetme, ku ka kryer aktivitet operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK, për vitin 2020, rezulton se ky i fundit ka paguar të gjitha detyrimet lidhur me taksat vendore, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2.3, të shtojcës 8, “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ankimues “Murati D” SHPK nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK me arsyen: *3- Disa nga mostrat e paraqitura janë jashtë specifikimeve teknike si:*

1- Pastrues për pllaka me arome 1.5 lit, Ajax ose Mastro Lindo ose ekuivalente me të.

Edhe kjo mostër ishte nën normë nga 1.5 lit u paraqit 1 litërshe.

2-Pastrues për parket të jetë Pronto Legno pulito (5 in 1) parket në formatin 500 ml ose ekuivalente me të.

Nuk ishte 500ml dhe marka nuk i pergjigjej kërkesave specifike.

3-Peceta enësh / Peshqir te jenë cilësore, materiali pambuk, 50% e sasisë në madhësinë 50x50 cm dhe 50% e sasisë në madhësinë 30x40 cm. Mostrat e paraqitura nuk ishin 30x40cm por jashtë këtyre përmasave.

III.3.1 Në dokumentet e tenderit Shtojca 8 pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”: parashikohet si më poshtë vijon :

2.3.3 Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet) **për disa prej artikujve** si më poshtë, në ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentet e tenderit.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.
- Mostrat do të dorëzohen përpara komisionit, në orën dhe datën e përcaktuar për hapjen e ofertave, në Sallën e Mbledhjeve të Bashkisë Fier, Kati II, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.

Lista e artikujve për të cilët kërkohen mostra është si më poshtë:

1. Açe blu (Nr. Rendor 1)
2. Pastrues për WC (Nr. Rendor 3)
3. Pastrues për banjo pulirapid ose ekuivalente me të (Nr. Rendor 6)
4. Pastrues për parket pronto ose ekuivalente me të (Nr. Rendor 7)
5. Pastrues pronto për mobilje ose ekuivalente me të (Nr. Rendor 8)
6. Shtupa mikrofiber për parket (Nr. Rendor 9)
7. Sapun lëng (Nr. Rendor 12)
8. Shtupa me mikrofibër (Nr. Rendor 17)
9. Peceta për xhamat (Nr. Rendor 22)
10. Dorashka (pako me nga dy pale) (Nr. Rendor 24)
11. Pastrues pllakash me arome (Nr. Rendor 36)

Shënim:

- 1.** Ne rast se oferta paraqitet nga bashkim operatorësh ekonomike, Shtojca nr.8 e DST (Kriteret e veçanta të kualifikimit) duhet të plotësohet në përputhje me nenin 74 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- 2.** Ne çmimin dhe vlerën e ofertës, përfshihen transporti i mallit/ve objekt prokurimi, si dhe të gjitha detyrimet apo kostot e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar apo praktikat më të mira, deri në destinacionin e kerkuar nga autoriteti kontraktor.
- 3.** Mallrat duhet të plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 9, në të kundërt AK nuk do t’i marre mallrat në dorëzim dhe do të kërkojë zëvendësimin e tyre derisa të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

III.3.2 Në shtojcën 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Blerje materiale pastrimi dhe detergjente

1. *Açe blu te jete Denso Piu Casa ose ekuivalente me te, ne formatin 2.5 lt.*
2. *Acid muriatico te jete me shishe 1 lt. hermetike.*
3. *Pastrues për WC te jete WC Net Gel, ose Duck ose ekuivalente me te ne formatin 750 ml.*
4. *Aromatizues për WC te jete Bref gogla treshe, poweractiv W.C 3x50 gr ose ekuivalente me te.*
5. *Pastrues për xhama te jete Ajax vetri & superfici brillanti ose ekuivalente me te ne formatin 750 ml.*
6. *Pastrues për tualete te jete Pulirapid Anticalcare ose Viakal ose ekuivalente me te ne formatin 750 ml.*
7. *Pastrues per parket te jete Pronto Legno pulito (5 in 1) parket ne formatin 500 ml ose ekuivalente me te.*
8. *Pastrues per mobilje te jete Pronto Legno pulito (5 in 1) mobilje aloe vera ne formatin 750 ml, ose ekuivalente me te.*
9. *Shtupa mikrofiber për parket te jene cilesore me shume fije, te gjata e te mbushura me mikrofiber, te pershtatshme me bishtat (Vileda ose ekuivalente me te).*
10. *Bishta për shtupa parketi, te forta dhe te pershtaten me shtupat per larje parketi, gjatesia 130 cm.*
11. *Peceta enësh / Peshqir te jene cilesore, materiali pambuk, 50% e sasise ne madhesine 50x50 cm dhe 50% e sasise ne madhesine 30x40 cm.*
12. *Sapun i lëngshëm për duart te jete cilesor, antibakterial, antialergjik me arome te kendshme Dermomed Crema di Sapone ose Dove ose ekuivalente me te ne formatin 1 lt.*
13. *Larës për enët te jete cilesor, Fairy ose ekuivalente me te, ne formatin 1 lit.*
14. *Letër higjenike te jete e plote, e bute, 12 rulona, me tre shtresa, permasat 9.4x11 cm, me gjatesi ne total 14.4 ml.*
15. *Letër për duart kuzhine te jene rulona te medhenj e te plote, e bute, diametri i rulonit 25-30 cm, paketim tek, me tre shtresa me 1000 copa, permasat e nje cope 20x22 cm, pesha e rulonit 1.2 kg.*
16. *Fshesë për merimangat te jete set me bisht zgjatues dhe me kokë rrumbullake.*
17. *Shtupa me mikrofiber për larje pllakash te jene cilesore me shume fije te gjata e te mbushura me mikrofiber, te pershtatshme me bishtat (Vileda ose ekuivalente me te).*
18. *Bishta për shtupa mikrofiber per larje pllakash te jene prej druri, te forta dhe te pershtaten me shtupat, gjatesia 130 cm.*
19. *Aromatik ambienti set te jete cilesor dhe me arome te kendshme, Essential oils 250 ml, Air Wick Set, Ambi Pur Aromatheray Essential oils set ose ekuivalente me te.*
20. *Pastrues xhamash te jete set me bisht zgjatues, gomë, 30 cm.*
21. *Peceta për pluhurat te jene mikrofibër, paketim 2 copë me permasa 36x34 (Vileda ose ekuivalente me te).*
22. *Peceta për xhamat te jene mikrofibër, paketim tek, permasa 30x30.*

23. Sfungjer enësh te jene cilesor, poroz dhe te medhenj me nje ane te ashper, (paketim set me 10 cope)
 24. Detergjent për pllakat te jete Ajax, Mastro Lindo ose ekuivalente me te, ne formatin 1 lit.
 25. Fshesë furçë për dysheme te jete me fije te dendura te qendrueshme, te gjata dhe te pershtatshme me bishtat.
 26. Bishta fshese te jene prej druri dhe te forte, pjesa e filetave te pershtatet me fshesat.
 27. Kova për shtrydhje te jene plastike me rrota, 10 lit.
 28. Brusha tualeti te jene plastike.
 29. Kosh për mbeturina te jete plastikë, 18 lt, pa doreza.
 30. Kosh për mbeturina te jete plastikë, 70 lt, pa doreza.
 31. Qese për mbeturina te jene 55x65 cm, pako që përmban 15 copë.
 32. Qese për mbeturina te jene 70x110 cm, pako që përmban 10 copë.
 33. Përparëse për Sanitaret te jene pambuk, me ngjyrë (jo të bardha), permasat sipas kërkeses se AK.
 34. Dorashka latex, te jene paketim ne 1 pako te jene 2 palë dorashka ose 4 copë.
 35. Lopate per mbeturinat me bisht te gjate, te jete plastike me bisht te gjate vertikal.
 36. Pastrues per pllaka me arome 1.5 lit, Ajax ose Mastro Lindo ose ekuivalente me te.
 37. Tel enesh (set) te jete material qe te mos ndryshket, ne forme suste, paketim ne set me 6 cope.
 38. Fshesa melakuqe te jete e cilesise se mire dhe e plote.
 39. Qeska për ushqime, te jene material i forte, te riciklueshme, 50% e sasise me madhesi 40x50 cm, dhe 50% e sasise me madhesi 30x40 cm.
 40. Kova uji me kapak te jene plastike, cilesore, 70 lt.
 41. Klor lëng te jete me shishe plastike 1 lt.
 42. Klor pluhur te jete i ambalazhuar ose pakeluar ne thase/ qeska 1 kg.
 43. Sapunet te jene cilesore, aromatik e me madhesi mesatare dhe peshe 125gr/cope, te jene te ambalazhuar per cdo cope sipas standardeve dhe te pakeluar ne sete me 3 deri ne 5 cope seti.
 44. Detergjent pluhur per lavatrice, te jete cilesor, paketim 3 kg.
 45. Pastrues pluhur për soba, te jete cilesor, paketim 1 kg, Vim ose ekuivalente me te.
 46. Pastrues leng për soba te jete Sgrasatore universale ose ekuivalente me te, ne formatin 1 lt.
 47. Kosh plehrash me kapak për mbeturinat te jete plastike me kapak, 10 lt.
 48. Lopatë për mbeturinat te jete plastike, e thjeshte, me bisht te shkurter.
 49. Pastrues për xhama te jete Ajax vetri & superfici brillanti ose ekuivalente me te ne formatin 1 lt.
 50. Detergjent pluhur per larje me dore te jete cilesor me paketim 1 kg.
- Per materialet e pastrimit dhe detergjentet te listuar me siper kerkohet qe te jene te certifikuar sipas standardeve dhe ne etikete te kene logon CE, per ato mallra qe eshte e mundur.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

III.3.3 Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”*

III.3.4 Në nenin 23, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.”*

III.3.5 Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose “

III.3.6 .Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006

“Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.3.7 .Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesat e autoritetit kontraktor në lidhje me mostrën e artikujve në shtojcën “Specifikime teknike”, janë elementë lehtësisht të dallueshëm, të verifikueshëm dhe të matshëm. Pas verifikimit të mostrave të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor, K.P.P. konstaton se artikujt “36.Pastrues per pllaka me arome 1.5 lit, Ajax ose Mastro Lindo ose ekuivalente me te, 7.Pastrues per parket te jete Pronto Legno pulito (5 in 1) parket ne formatin 500 ml ose ekuivalente me te dhe 11.Peceta enësh / Peshqir te jene cilesore, materiali pambuk, 50% e sasise ne madhesine 50x50 cm dhe 50% e sasise ne madhesine 30x40 cm.. të dorëzuara në cilësinë e mostrës nga operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK është në përputhje me specifikimet teknike, pasi nga verifikimi i kryer pranë KPP rezultoi se Pastruesi i Pllakave ishte sipas specifikimit të vendosur nga autoriteti 1.5lit, gjithashtu dhe pastruesi për parket ishte sipas specifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor 500 ml dhe marka ishte e njëjtë.

Në lidhje me mostrën nr. 11.Peceta enësh / Peshqir të jenë cilësorë, materiali pambuk, 50% e sasisë në madhësinë 50x50 cm dhe 50% e sasisë në madhësinë 30x40 cm, nuk është kërkuar ky artikull si mostër te lista e artikujve të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor, rrjedhimisht ky pretendim nuk qëndron, pasi operatori ekonomik nuk është i detyruar të sjellë produkte për të cilat nuk janë kërkuar mostra.

III.3.8 .Komisioni thekson se kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit, apo dorëzimi i qoftë një mostre jo në përputhje me specifikimet teknike, përbën shkak për skualifikim. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara. Në rastin konkret mostrat për artikujt “36.Pastrues per pllaka me arome 1.5 lit, Ajax ose Mastro Lindo ose ekuivalente me te, 7.Pastrues per parket te jete Pronto Legno pulito (5 in 1) parket ne formatin 500 ml ose ekuivalente me te” të dorëzuar nga operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK, konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Murati D” SHPK, nuk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Murati D” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.4.1. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.4.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.4.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është, që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK, të palës ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 18.03.2021 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK mbetet e kualifikuar. Pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, në rastin konkret për operatorin ekonomik “Ervin Luzi” SHPK, nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, , njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Murati D” SHPK për procedurën e prokurimit, “Kërkesë për propozim”, me objekt “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente”, me nr. REF-88696-03-01-2021, me fond limit 4,814,770.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.03.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 579 protokoli Datë 08.04.2021;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri